



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

### DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE BERAT

#### SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

### KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Objekti dhe baza ligjore

1. DRTK-Berat, në përmbushje të detyrave të saj funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit Nr.27/2018, lidhur me:
  - a) Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat (DRTK-Berat);
  - b) Administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të DRTK-Berat.
2. Funksionimi i DRTK-Berat mbështetet në Nenin 119 të Kushtetutës, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimit nr. 581, datë 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, të Këshillit të Ministrave si dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 28.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

### Neni 2

#### Misioni dhe veprimtaria

1. DRTK-Berat është institucion rajonal i specializuar, tekniko-administrativ buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore që ushtron veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore, me seli në Berat.
2. DRTK-Berat financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. DRTK-Berat ushtron veprimtarinë e saj në fushën e trashëgimisë kulturore me qëllim gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore në territorin që administron.
4. Në veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve, DRTK-Berat monitorohet dhe koordinohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK), si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-

ve. DRTK-Berat bashkëpunon dhe bashkërendon punën me:

- a) Institucionet e tjera në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) Organet e administratës qendrore;
- c) Organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) Institucion dhe organizata të tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë dhe juridikë për gjurmimin, evidentimin, studimin, konservimin, restaurimin, promovimin dhe publikimin e pasurive kulturore.

5. DRTK-Berat ka këto kompetenca:

- a) Të zbatojë konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore.
- b) Të gjurmtojë dhe përgatis vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes.
- c) Të kryej verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura.
- d) Të hartoj projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendore.
- e) Të kryej punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara.
- f) Të kryej mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore dhe materiale.
- g) Të kryej çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

6. DRTK- Berat ushtron veprimtarinë në Qarkun e Beratit.

- a) Bashkinë Berat,
- b) Bashkinë Kucovë;
- c) Bashkinë Dimal;
- d) Bashkinë Skrapar;

7. DRTK- Berat realizon aktivitetin nën monitorimin e koordinimin e IKTK-së dhe në bashkëpunim me:

- a) institucionet e tjera në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) organet e administratës qendrore;
- c) organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) institucionet e tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë e juridikë për gjurmimin, evidentimin, studimin, konservimin, restaurimin, promovimin e publikimin e pasurive kulturore.